

KONTRATA E TRANSFERIMIT TE AKSIONEVE

Kjo Kontrate Transferimi Aksionesh ("**Kontrata**") është lidhur në datë 25.02.2025, nga dhe midis:

ABOUT TIME SHPK, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më numrin e regjistrimit (NUIS): M42327011S, me selinë e saj të regjistruar në: Rruga 17 Nëntori, Godina Nr.20, Mëzes Kodër, Kashar, Tirane, Shqipëri, **përfaqësuar nga administratori Znj. Lorela Hoxha**, atësia Dritan, amësia Vjollca, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Blv.Bajram Curri; Nd. Etc; H. Shk.B; Ap. 14/7; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 19/10/1993, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporten nr. BC1432168 dhe nr. personal J36019045D (më tej referuar si "**Blerësi**")


Dhe

- **UNION GRUP SHA**, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më numrin e regjistrimit (NUIS) K61527801R me selinë e saj të regjistruar në: Rruga Ismail Qemali, Nr.32/1, kati 3, Njësia Bashkiake nr. 5, 1019, Tirane, Shqipëri, **përfaqësuar nga administratori Z. Niko Leka** atësia Vlash, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Perlat Rexhepi; Nd. 1; H. 6; Ap. 60; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 31/03/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033380369 dhe nr. personal G10331096G (më tej referuar si "**Shitësi**");

Shitësi së bashku me Blerësin do të referohen këtu e në vijim si "**Palët**", ndërsa secila prej tyre do të referohet në veçanti si "**Palë**".

NDËRKOHË:

- A. Shitësi është pronar i 31,291 (tridhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë) aksioneve të nënshkruara dhe plotësisht të shlyera, që përfaqësojnë 13,6 % të kapitalit aksionar (me tej "**Aksionet**") të shoqërisë "**DIGIT-ALB**" SHA, një shoqëri aksionare, e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më numrin e regjistrimit (NUIS) K41719004D me selinë e saj të regjistruar në: Rruga Pavarësia, nr 39, Kashar, Tirane, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**");
- B. Shitësi synon të shesin tek Blerësi të gjitha Aksionet të cilat ai zotëron tek Shoqëria dhe Blerësi synon të blejë këto Aksione, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshje;
- C. Shitësit dhe Blerësi kanë nënshkruar një Marrëveshje Shitje dhe Blerje Aksionesh në datën 07/01/2025 ("**Marrëveshja Kryesore**") për shitjen dhe blerjen e Aksioneve. Shitësi dhe Blerësi, pavarësisht tejkalimit të afatit të datës 31 Janar 2025, të parashikuar në Nenin 3 të Marrëveshjes Kryesore, për nënshkrimin e kësaj Kontrate, vendosin që të nënshkruajnë këtë Kontrate në datën e vendosur më lart si dhe vendosin të zgjasin çdo efekt të Nenit 3 të Marrëveshjes Kryesore, deri në datën e kësaj Kontrate;
- D. Palët konfirmojnë dhe pranojnë që nga dita e kësaj Kontrate deklaratat dhe garancitë e parashikuara në Marrëveshjen Kryesore janë ende të vlefshme dhe të vërteta;



NË VAZHDIM, ËSHTË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

1. TRANSFERIMI I AKSIONEVE

- 1.1 Shitësi ne datën e kësaj Kontrate shet dhe transferon tek Blerësi dhe Blerësi ne datën e kësaj Kontrate blen dhe merr nga Shitësi, pronësinë e Aksioneve të Shoqërisë.
- 1.2 Për transferimin pronësisë se Aksioneve sipas paragrafit 1.1 më sipër, Blerësi i paguan Shitësve Çmimin e Blerjes në shumën dhe sipas modaliteteve të rëna dakord në Marrëveshjen Kryesore.
- 1.3 Me transferimin e pronësisë se Aksioneve nga Shitësit ke Blerësi ne datën e kësaj Kontrate, Blerësi është aksionari i ri i Shoqërisë dhe zotëron **31,291 aksione te Shoqërisë** qe përfaqësojnë **13,6 % te kapitalit aksionar te Shoqërisë**. Shitësi del përfundimisht nga kapitali aksionar i Shoqërisë dhe nuk është me aksionare te Shoqërisë.

2. DISPOZITAT E ZBATUESHME

- 2.1 Kjo Kontrate së bashku me Marrëveshjen Kryesore përbëjnë të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve dhe të gjitha dispozitat e Marrëveshjes Kryesore zbatohen tërësisht për këtë Kontrate.
- 2.2 Çdo afat dhe efekt i Nenit 3 te Marrëveshjes Kryesore do te zgjatet deri ne datën e nënshkrimit te kësaj Kontrate.

3. KOPJET

- 3.1 Kjo Kontrate mund të ekzekutohet dhe dorëzohet në një ose më shumë kopje, dhe nga palët e ndryshme të kësaj Kontrate nëpërmjet kopjeve të veçanta, secila prej tyre në momentin që ekzekutohet do të konsiderohet të jetë origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.
- 3.2 Kjo Kontrate nënshkruhet ne 3 kopje në gjuhen shqipe, te gjitha me vlere te njëjtë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, përfaqësuesit e Palëve vendosen nënshkrimet e tyre në datën e shkruar me sipër.

PER BLERESIN

ABOUT TIME SHPK

Lorela Hoxha



PER SHITESIN

UNION GRUP SHA

Niko Leka



